KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Tiranë, më 02/08/2021

NJOFTIM PËR SHTYP

# Webinar-i IV i Projektit të Binjakëzimit, prezantimi i ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin shëndetësor

Webinar-i i katërt i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në kuadër të zbatimit të Projektit të Binjakëzimit "*Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e BE*" (*dissemination event*) u zhvillua me institucionet publike dhe subjektet private që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin shëndetësor.




Në trajnim morën pjesë mbi 50 përfaqësues nga këto organizata, të cilët u njohën me risitë e legjislacionit të ardhshëm, ndikimin që do të ketë në procesin e përpunimit të të dhënave personale, si dhe me ecurinë e zbatimit të Projektit të Binjakëzimit. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në funksionimin e tyre ishte tjetër aspekt i rëndësishëm që u trajtua në këtë webinar. Si një nga sektorët më të mëdhenj në mbledhjen e të dhënave personale, respektimi i të drejtave të qytetarëve është i rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm të tij në tërësi dhe sidomos, në aspektin teknologjik.

Trajnerë në këtë aktivitet ishin ekspertë nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, CSI-Piemonte në Itali dhe të Zyrës së Komisionerit.

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë — Telefon: 00355 4 2237200
*www.idp.al* — *e-mail: info@idp.al*